



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.35

2005

26 maj

P Ë R M B A J T J A

	Faqe	
Vendim i KM nr.310, datë 6.5.2005	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.244, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e projektit pilot dhe të skemës së furnizimit me karburant, pa akcizë, për përcaktimin e sasive të karburantit, që do të përdoren për mekanikën bujqësore në tri zona të vendit dhe për serat me ngrohje”.....	1287
Vendim i KM nr.311, datë 6.5.2005	Për një ndryshim në vendimin nr.495, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve, të personave dhe të sasisë së nevojshme të karburantit për përdorim nga anijet e peshkimit”, të ndryshuar.....	1287
Vendim i KM nr.317, datë 13.5.2005	Për miratimin e Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të Bashkimit Europian dhe zbatimit të angazhimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asocimit.....	1288
Vendim i KM nr.318, datë 13.5.2005	Për disa ndryshime në vendimin nr.787, datë 26.11.2003 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e fazës së katërt të ngushtimit të diferencave në masën e pensioneve”.....	1289

Vendim i KM nr.319, datë 13.5.2005	Për zbatimin e fazës së pestë të ngushtimit të diferencave në masën e pensioneve.....	1289
Vendim i KM nr.323, datë 13.5.2005	Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së mesme të përgjithshme, të profilizuar “Arsakeio”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën greke.....	1292
Vendim i KM nr.327, datë 15.4.2005	Për caktimin e pagës së drejtorit ekzekutiv dhe të raportit të pagës maksimale e minimale të punonjësve të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.....	1292
Vendim i KM nr.328, datë 13.5.2005	Për një ndryshim në vendimin nr.102, datë 5.3.1999 të Këshillit të Ministrave “Për një trajtim me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, të ndryshuar.....	1293
Vendim i KM nr.329, datë 13.5.2005	Për procedurat e rekrutimit të ushtarëve profesionistë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.....	1293
Vendim i KM nr.330, datë 13.5.2005	Për sigurimin e të dhënave për pronat publike dhe private, në funksion të realizimit të procesit të kthimit dhe kompensimit të tyre	1297
Udhëzim i KM nr.2, datë 13.5.2005	Për zbatimin e punimeve të ndërtimit	1298
Udhëzim i ME nr.132, datë 18.5.2005	“Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr.4, datë 11.6.2003 “Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”.....	1306

VENDIM
Nr. 310, datë 6.5.2005

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.244, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT DHE TË SKEMËS SË FURNIZIMIT ME KARBURANT, PA AKCIZË, PËR PËRCAKTIMIN E SASIVE TË KARBURANTIT, QË DO TË PËRDOREN PËR MEKANIKËN BUJQËSORE NË TRI ZONA TË VENDIT DHE PËR SERAT ME NGROHJE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 9 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.244, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shitesa:

1.Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Fermerët, që kryejnë punime të mekanizuara në bujqësi, sera me ngrohje dhe subjektet, që kanë kaldaja në linjat e përpunimit të qumështit, të furnizohen me karburant dhe lubrifikante, pa akcizë, në të gjithë vendin.”.

2.Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2.” ARMO” sh.a., për periudhën maj-dhjetor 2005, të furnizojë fermerët, që përfitojnë nga ky vendim, me 24 000 tonë gazoil, 500 tonë vajra lubrifikante, 4000 tonë solar, me çmimin e programuar, pa akcizë.”.

3. Pas pikës 5, shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Projektit 2KR, për zbatimin e këtij vendimi, t’i shtohen 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekë, kosto lokale nga fondet e miratuara për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, zëri “Kosto lokale e projekteve”.”

4. Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

“7. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 311, datë 6.5.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.495, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, TË PERSONAVE DHE TË SASISË SË NEVOJSHME TË KARBURANTIT PËR PËRDORIM NGA ANIJET E PESHKIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e vendimit nr.495, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Shoqëri furnizuese e gazoilit, për anijet e peshkimit, të jetë “ARMO” sh.a., Fier. Çmimi i shitjes të jetë sipas çmimit vjetor të programuar, miratuar nga Ministria e Ekonomisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 317, datë 13.5.2005

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË PËRAFRIMIT TË LEGJISLACIONIT
VENDAS ME ATË TË BASHKIMIT EUROPIAN DHE ZBATIMIT TË ANGAZHIMEVE,
QË RRJEDHIN NGA MARRËVESHJA E STABILIZIM-ASOCIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Integritimit Europian, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të Bashkimit Europian dhe Zbatimit të Angazhimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Plani Kombëtar i Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të Bashkimit Europian dhe Zbatimit të Angazhimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, plotëson dhe përmirëson angazhimet e marra në Planin e Veprimit për Zbatimin e Përparësive të Partneritetit Europian.

3. Ministri i Integritimit Europian të ndjekë zbatimin e Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të Bashkimit Europian dhe Zbatimit të Angazhimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, nga ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore dhe të raportojë në Këshillin e Ministrave.

4. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave, të informojnë pranë Ministrit të Integritimit Europian, në fillim të çdo tremujori, për realizimin e detyrave, që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të Bashkimit Europian dhe Zbatimit të Angazhimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, dhe për realizimin e detyrave të parashikuara në vendimin nr.634, datë 30.8.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Përparësive të Partneritetit Europian”.

5. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të paraqesin propozimet, përkatësisht në:

a) Ministrinë e Financave dhe Departamentin e Administratës Publike, për shtesa dhe ndryshime në burimet njerëzore, në mbështetje të objektivave të parashikuara në këtë plan kombëtar, të cilat të jenë objekt shqyrtimi e miratimi nga këto institucione, përpara miratimit përfundimtar sipas ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, për strukturat e organikat e institucioneve shtetërore.

b) Ministrinë e Financave, për nevojat financiare për zbatimin e masave afatshkurtra, të parashikuara në Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të Bashkimit Europian dhe Zbatimit të Angazhimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asocimit.

6. Ngarkohet Ministri i Integritimit European, që brenda 6-muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të propozojë në Këshillin e Ministrave projektvendimin për miratimin e instrumenteve të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit European.

7. Ngarkohen të gjitha ministratë dhe institucionet, për të cilat në Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të Bashkimit European dhe Zbatimit të Angazhimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, janë përcaktuar detyra specifike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 318, datë 13.5.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.787, DATË 26.11.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E FAZËS SË KATËRT TË NGUSHTIMIT TË
DIFERENCAVE NË MASËN E PENSIONEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 4 të vendimin nr.787, datë 26.11.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë fjalët “... në periudhën nga 1.1.1997 deri më 30.6.2000” zëvendësohen me “... në periudhën nga 1.1.1997 deri më datë 31.12.1998”.

2. Në shkronjën “b”, fjalët “...në periudhën nga 1.2.1998 deri më 30.6.2000” zëvendësohen me “...në periudhën nga 1.2.1998 deri më 31.12.1998”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 319, datë 13.5.2005

PËR ZBATIMIN E FAZËS SË PESTË TË NGUSHTIMIT TË DIFERENCAVE NË MASËN E
PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, me datë fillimi deri në datën 30.6.1991, që në këtë datë kanë masë pensioni nga 417 (katërqind e shtatëmbëdhjetë) lekë deri në 700 (shtatëqind) lekë, dhe që më datë 1.7.2004 kanë arritur masën nga 7366 (shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë deri në 12 370 (dymbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë në muaj, shtohen me shuma fikse nga 21 (njëzet e një) lekë deri në 1671 (një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) lekë në muaj.

2. Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, në periudhën nga 1.7.1991 deri më 30.9.1993, që në këtë datë kanë masë pensioni nga 1238 (një mijë e dyqind e tridhjetë e tetë) lekë deri në 1967 (një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, dhe më datë 1.7.2004 kanë arritur masën nga 7814 (shtatë mijë e tetëqind e katërmëdhjetë) lekë deri në 12 370 (dymbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë, në muaj, shtohen me shuma fikse nga 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) lekë, deri në 1671 (një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) lekë në muaj.

3. Pensionet e parakohshme, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, me datë fillimi deri më 30.9.1993, që në këtë datë kanë masë pensioni 1245 (një mijë e dyqind e dyzet e pesë) lekë deri në 1967 (një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë në muaj dhe më datë 1.7.2004 kanë arritur masën nga 7376 (shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë deri në 11 650 (njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë, shtohen me shuma fikse nga 21 (njëzet e një) lekë deri në 1425 (një mijë e katërqind e njëzet e pesë) lekë.

4. Shtesat e pensionit, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi, i përfitojnë vetëm pensionistët, që vazhdojnë të paguhen pas datës së shtrirjes së efekteve financiare të këtij vendimi.

5. Efektet financiare, për vitin 2005, llogariten në shumën 325 000 000 (treqind e njëzet e pesë milionë) lekë dhe të përballohen brenda planit të përgjithshëm të shpenzimeve të miratuara për këtë vit, për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

6. Shumat individuale të shtesës së pensionit, të llogaritura sipas pikave 1, 2, 3 përcaktohen në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a., për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.5.2005.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

	Masa e pensionit pas 01.07.2004	Shtesa
gr0	7366-7499	21
gr1-0	7500-7599	60
gr1-1	7600-7699	100
gr1-2	7700-7799	130
gr1-3	7800-7899	160
gr1-4	7900-7999	195
gr2-0	8000-8049	220
gr2-1	8050-8099	237
gr2-2	8100-8149	252
gr2-3	8150-8199	269
gr2-4	8200-8249	287
gr2-5	8250-8299	305
gr2-6	8300-8349	320
gr2-7	8350-8399	334
gr2-8	8400-8449	350
gr2-9	8450-8499	370
gr3-0	8500-8549	388
gr3-1	8550-8599	403
gr3-2	8600-8649	420
gr3-3	8650-8699	436
gr3-4	8700-8749	454
gr3-5	8750-8799	470
gr3-6	8800-8849	487
gr3-7	8850-8899	502
gr3-8	8900-8949	520
gr3-9	8950-8999	537
gr4-0	9000-9049	555
gr4-1	9050-9099	572
gr4-2	9100-9149	586
gr4-3	9150-9199	602
gr4-4	9200-9249	620
gr4-5	9250-9299	638
gr4-6	9300-9349	655
gr4-7	9350-9399	673
gr4-8	9400-9449	689
gr4-9	9450-9499	705
gr5-0	9500-9549	720
gr5-1	9550-9599	738
gr5-2	9600-9649	755
gr5-3	9650-9699	768
gr5-4	9700-9749	787
gr5-5	9750-9799	803
gr5-6	9800-9849	822
gr5-7	9850-9899	840
gr5-8	9900-9949	855
gr5-9	9950-9999	872
gr6-0	10000-10049	889
gr6-1	10050-10099	908
gr6-2	10100-10149	921
gr6-3	10150-10199	939
gr6-4	10200-10249	955
gr6-5	10250-10299	971
gr6-6	10300-10349	988
gr6-7	10350-10399	1005
gr6-8	10400-10449	1022
gr6-9	10450-10499	1039

	Masa e pensionit pas 01.07.2004	Shtesa
gr7-0	10500-10549	1054
gr7-1	10550-10599	1072
gr7-2	10600-10649	1089
gr7-3	10650-10699	1105
gr7-4	10700-10749	1122
gr7-5	10750-10799	1138
gr7-6	10800-10849	1155
gr7-7	10850-10899	1174
gr7-8	10900-10949	1190
gr7-9	10950-10999	1205
gr8-0	11000-11049	1221
gr8-1	11050-11099	1240
gr8-2	11100-11149	1255
gr8-3	11150-11199	1272
gr8-4	11200-11249	1290
gr8-5	11250-11299	1305
gr8-6	11300-11349	1322
gr8-7	11350-11399	1340
gr8-8	11400-11449	1357
gr8-9	11450-11499	1373
gr9-0	11500-11549	1389
gr9-1	11550-11599	1405
gr9-2	11600-11649	1425
gr9-3	11650-11699	1440
gr9-4	11700-11749	1458
gr9-5	11750-11799	1472
gr9-6	11800-11849	1490
gr9-7	11850-11899	1505
gr9-8	11900-11949	1523
gr9-9	11950-11999	1542
gr10-0	12000-12049	1555
gr10-1	12050-12099	1572
gr10-2	12100-12149	1588
gr10-3	12150-12199	1608
gr10-4	12200-12249	1624
gr10-5	12250-12299	1640
gr10-6	12300-12370	1670

VENDIM
Nr. 323, datë 13.5.2005

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË MESME TË PËRGJITHSHME,
TË PROFILIZUAR “ARSAKEIO”, QË DO TA ZHVILLOJË MËSIMIN EDHE NË GJUHËN
GREKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës së mesme të përgjithshme, të profilizuar “Arsakeio”, si institucion arsimor jopublik, parauniversitar, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën greke, në qytetin e Tiranës.
 2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave, ligjore e nënligjore, të arsimit, edukimit dhe formimit në këtë institucion.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 327, datë 15.4.2005

**PËR CAKTIMIN E PAGËS SË DREJTORIT EKZEKUTIV DHE TË RAPORTIT TË PAGËS
MAKSIMALE E MINIMALE TË PUNONJËSVE TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË
SIGURIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve” dhe të pikës 3 të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paga mujore e drejtorit ekzekutiv të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve të jetë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
2. Raporti i pagës maksimale me atë minimale të punonjësve të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve të jetë 1 me 6.
3. Nëpunësit civilë të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve përfitojnë shtesë mbi pagën bazë, për kushtet e punës, në masën deri në 35 për qind, sipas përcaktimit të drejtorit ekzekutiv të këtij institucioni.
4. Nëpunësit civilë të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve përfitojnë shtesë mbi pagën bazë, të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, në përputhje me kriteret e kualifikimit dhe kushtet e punës si më poshtë vijon:

- a) Të kenë përgjegjësi të drejtpërdrejtë në vendimmarrje, në marrëdhënie me shoqëritë e sigurimit;
 - b) të kenë kualifikime në sektorin financiar e veçanërisht në mbikëqyrje;
 - c) të punojnë drejtpërdrejt me aktuaristikën, analizën e gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit;
 - ç) të inspektojë gjendjen në tregun e sigurimeve apo të shoqërive të sigurimit;
 - d) të jenë të lidhur drejtpërdrejt në procesin e licencimit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 328, datë 13.5.2005

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.102, DATË 5.3.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NJË TRAJTIM ME STREHIM TË FUNKSIONARËVE POLITIKË
DHE NËPUNËSVE CIVILË TË ADMINISTRATËS SË LARTË SHTETËRORE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 20 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit”, të nenit 30 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005” dhe të nenit 12 të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e vendimit nr.102, datë 5.3.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Në kuptim të këtij vendimi, trajtohen me strehim funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë të shtetit, si dhe personat me cilësi të veçanta”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 329, datë 13.5.2005

**PËR PROCEDURAT E REKRUTIMIT TË USHTARËVE PROFESIONISTË NË FORCAT E
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 34 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në komandat e forcave dhe komandat mbështetëse të funksionojnë qendrat e rekrutimit të ushtarëve profesionistë.

2. Për rekrutimin e ushtarëve/detarëve profesionistë të krijohet një qendër e përhershme nga Komanda e Doktrinave dhe Stërviçjes në Brigadën e Stërviçjes, në Bunavi.

3. Në strukturat e përmendura në pikat 1 dhe 2, të ngrihen e të funksionojnë komisionet e përzgjedhjes së ushtarëve/detarëve profesionistë, të cilat të kryesohen, përkatësisht, nga drejtori i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërviçjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, nga shefi i shtabit të strukturës përkatëse, dhe në përbërje të kenë komandantët e drejtpërdrejtë të reparteve.

Komisionet, për vlerësimin e kandidatëve, të përdorin formularin nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Për ushtarët/detarët e përzgjedhur, në repartet në varësi të drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, titullimi dhe nënshkrimi i kontratës të bëhet nga zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ndërsa për ushtarët/detarët në komandat e forcave dhe ato mbështetëse të bëhen nga komandanti i strukturës përkatëse.

Një kopje e kontratës së nënshkruar dërgohet në Drejtorinë e Personel-Organizimit.

5. Pranimi i ushtarëve/detarëve profesionistë të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 5, shkronja “dh”, 16, 17 e 18 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe me numrin limit të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes, i cili përcakton edhe kriteret e rregullat për funksionimin e komisioneve.

6. Kandidati, i cili aplikon për ushtar/detar profesionist, duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesën;
- Certifikatën personale me fotografi;
- Certifikatën familjare;
- Dëshminë e penalitetit;
- Vërtetimin se nuk është në proces hetimi nga prokuroria;
- Vërtetimin se nuk është në proces gjykimi nga gjykata;
- Rezultatin e testeve dhe të ekzaminimeve mjekësore, brenda 6 muajve nga paraqitja e formularit të aplikimit;
- Vërtetimin për arsimin më të lartë, të kryer;
- Formularin nr.1 të aplikimit të plotësuar, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

FORMULAR NR.1

Forcat e Armatosura te RSII
Formulari i Aplikimit për Ushtarët/Detarët Profesionalë

Emri: _____

Atësia: _____

Mbiemri: _____

Nr. pasaportës/çertifikatës: _____

Seksi (rretho): **Masikull** **Femër**

Kombësia: _____

Shtetësia: _____

Adresa e shtëpisë/ Adresë kontaktimi: _____

Nr. Telefoni: _____ Nr. celular: _____

Arsimi (Niveli më i lartë që keni kryer): _____

Dua të bëhem ushtar/detar profesionist ne Forcat e Armatosura Shqiptare ne (zgjidh dhe rretho nje): **Forcat Tokesore** **Forcat Ajrore** **Forcat Detare**

dhe te perzgjidhem ne specialitetin: _____

(Sipas nevojave te FASH), per keto arsye: _____

Firma e Aplikantit: _____

Data e Aplikimit: _____

Bashkëlidhur 7 dokumenta.

1. Çertifikatë personale
2. Çertifikatë familjare
3. Vërtetim nga Prokuroria
4. Vërtetim nga Gykata
5. Dëshmi penaliteti
6. Vërtetim për arsimin më të lartë të kryer
7. Vërtetim për aftësi profesionale

Për Komisionet e Karrierës (Verifikimi i aplikimit/Vendimi i Komisionit):

Emri i Komisionit të Karrieres: _____

Data e marrjes së aplikimit: _____

Data e verifikimit të aplikimit: _____

Vendimi (Pranuar): Data e dërgimit te ofertës _____

=====

Vendimi (**NUK** është pranuar): Data e dërgimit të letrës: _____

=====

Shënime:

VENDIM
Nr. 330, datë 13.5.2005

**PËR SIGURIMIN E TË DHËNAVE PËR PRONAT PUBLIKE DHE PRIVATE, NË
FUNKSION TË REALIZIMIT TË PROCESIT TË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË
TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet që administrojnë prona shtetërore si tokë bujqësore, tokë pyjore, pyje, livadhe, kullota, troje dhe ndërtesa, në kuadër të inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, të përcaktojnë listën e pronave shtetërore, të shpronësuara, pas datës 29.11.1944, të personave fizikë e juridikë, privatë, të cilat nuk përdoren për qëllim të shpronësimit, dhe ta vënë atë në dispozicion të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave.

Kur institucioni ka vendosur të heqë dorë nga administrimi i një prone shtetërore nuk mund ta kalojë atë në administrim apo pronësi të një institucioni tjetër shtetëror, pa marrë, paraprakisht, mendimin e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave.

2. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të vërë në dispozicion të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, këto dokumente:

- Hartat e zonave, që kanë përparësi zhvillimin e turizmit;
- Mastërplanet e studimeve të zonave turistike, për një periudhë afatmesme 10-vjeçare;
- Të dhëna të hollësishme për fshatrat turistike të ndërtuar, në ndërtim apo të projektuar për t'u ndërtuar në zonën turistike, vendndodhjen e tyre, dhe sipërfaqet e zëna.

3. Për rastet kur, pas verifikimit të pronave shtetërore nga komisionet vendore, rezulton se ndonjëra nga këto prona ka pronar dhe përmbush kushtet e parashikuara në paragrafin e parë, të pikës 1 të këtij vendimi, atëherë Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe i Kompensimit të Pronave, brenda 2 muajve, i kërkon institucionit shtetëror përkatës, që administron pronën, t'i propozojë Ministrisë së Ekonomisë fillimin e procedurave për privatizimin e saj.

Ministria e Ekonomisë, për objektet shtetërore, për të cilat duhet të fillojnë procedurat e privatizimit, duhet të vërë në dijeni, paraprakisht, Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, i cili brenda dy muajve, duhet të japë përgjigje për pronësinë e tokës, me qëllim garantimin e ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga ish-pronari.

4. Të gjitha institucionet shtetërore, që zotërojnë dokumentacion për shpronësimet e bëra nga shteti pas datës 29 nëntor 1944, t'ia vënë atë në dispozicion Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të shoqëruar me këto të dhëna:

- Listën e subjekteve të shpronësuara, pronat e të cilave vazhdojnë të përdoren për interesa publike;
- Listën e personave, që ia kanë dhuruar pronat e tyre shtetit, veprim për të cilin ka dokumente zyrtare;
- Listën e subjekteve të shpronësuara, pronat e të cilave janë përmbytur nga ndërtimi i hidrocentraleve, e që janë kompensuar sipas dispozitave për shpronësimet për interes publik.

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (Arkivi Qendror i Shtetit) duhet të paraqesë dokumentacionin ndihmës pranë ministrive dhe institucioneve, sipas kërkesave të tyre, për verifikimin e gjendjes së pronave në administrim të tyre e të atyre të shpronësuara, pas datës 29 nëntor 1944, të personave fizikë, privatë.

5. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

UDHËZIM
Nr. 2, datë 13.5.2005

PËR ZBATIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 9, 10 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

KREU I
SIPËRMARRËSI I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

1. Sipërmarrës për zbatimin e punimeve të ndërtimit është çdo subjekt juridik, vendas ose i huaj, publik ose privat, i licencuar nga komisioni i dhënies së licencave profesionale, pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, për të ushtruar veprimtari në zbatimin e punimeve të ndërtimit.

Licenca i jepet subjektit zbatues në emër të drejtuesit ligjor dhe teknik të tij.

1.1 Çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrorjë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licencë.

Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licencave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

1.2 Drejtuesit ligjorë dhe teknikë të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi.

1.3 Edhe në rastet kur investitori ndërton për llogari të vet, ai duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

2. Detyra e drejtuesit teknik të sipërmarrësit është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës.

2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

2.2 Ndarja e detyrave dhe e përgjegjësiive të sipërmarrësit e të kantierit, marrëdhëniet me investitorin, mbikëqyrësin, administratën publike dhe rregulli në kantier përcaktohen në rregulloren e brendshme, që hartohet nga sipërmarrësi i punimeve.

3. Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit. Përmbajtja e kontratës nuk është mjet për të shmangur zbatimin e standardeve dhe të rregullave teknike, në fuqi.

3.1 Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, në kushtet dhe afatet e përcaktuara, investitori i dorëzon sipërmarrësit në origjinal:

- a) dokumentacionin administrativo-ligjor për truallin dhe sheshin e ndërtimit;
- b) lejen e ndërtimit;
- c) projektin e zbatimit për punimet e ndërtimit, të infrastrukturës, montimit, sistemimit të territorit dhe preventivin e punimeve;
- c) planin e vendosjes (piketimit) të objektit;
- d) përshkrimin teknik të punimeve dhe specifikimet teknike;
- dh) lidhjen e veprës me infrastrukturën e zonës;
- e) studimet inxhinierike, për ndërtimin e veprës (gjeologjik, sizmik, topografik, gjeoteknik, hidrologjik, hidraulik, të materialeve e produkteve të ndërtimit etj.).

3.2 Sipërmarrësi ruan dhe nuk lejon përdorimin a kalimin e pronësise së dokumenteve, që i vë në dispozicion investitori, te personat e paautorizuar.

3.3 Sheshi i liruar për ndërtim (për objektet e reja) ose mjediset, që do të rikonstruktohen, (për objektet ekzistuese) i dorëzohet sipërmarrësit, nga investitori, me procesverbal, në tërësi ose pjesë-pjesë, sipas kushteve të kontratës apo gjendjes faktike.

3.4 Sipërmarrësi, brenda një afati të pranuar nga palët paraqet kërkesë-propozimet për korrigjime, plotësime apo përmirësime në projekt dhe për mungesat e pasaktësitë, ligjore a kontraktuale të dokumentacionit të dorëzuar.

Kërkesë-propozimet i paraqiten mbikëqyrësit nga sipërmarrësi, gjatë zhvillimit të punimeve, sa herë që gjykohet e arsyeshme prej tij.

4. Për zbatimin e punimeve të ndërtim-montimit, në sheshin e liruar të ndërtimit ngrihet, përkohësisht, kantieri i punimeve, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në projektorganizim.

4.1 Drejtimi i kantierit sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga sipërmarrësi ose nga drejtuesit e kantierit (drejtori i punimeve/përgjegjësi teknik i kantierit), që emërohen prej tij.

Në rastet kur drejtuesi ligjor e teknik i sipërmarrësit nuk udhëheq drejtpërdrejt punimet në kantier njoftohet, zyrtarisht, investitori për drejtuesit e punimeve dhe personat e tjerë, të emëruar me detyrë në kantier.

5. Projektorganizimi i punimeve përmban planin e ngritjes dhe të organizimit të kantierit, grafikun e përgjithshëm të punimeve dhe planin e veprimit, për ndërtimin e objektit, sipas projektit, në përputhje me afatet dhe kushtet e kontratës.

5.1 Në planin e veprimit përcaktohet tërësia e burimeve njerëzore e materialo-teknike, masat organizative e teknologjike që merr sipërmarrësi në kantier për realizimin e kontratës dhe konkretisht:

- a) Burimet për realizimin e punimeve, sipas projektit dhe në afat;
- b) Masat për mbrojtjen, sigurinë dhe higjienën në punime dhe në kantier;
- c) Kujdesin për mbrojtjen e mjedisit të infrastrukturës ekzistuese në kantier, të strukturave ndërtimore në afërsi dhe punimeve në kushte të veçanta;
- ç) Masat për të siguruar e dokumentuar respektimin e kushteve teknike dhe radhën teknologjike të punimeve të ndërtimit;
- d) Procedurat e kontrollit të punimeve, që bëhen të padukshme;
- dh) Punimet topografike;
- e) Testimet e materialeve, të produkteve dhe provat pa ngarkesë të rrjetave të infrastrukturës e të punimeve të montimit.

5.2 Sipërmarrësi njofton për planin e veprimit dhe realizimin e detyrave të kontratës brenda afateve kohore të caktuara nga investitori.

5.3 Sipërmarrësi, me kërkesë të mbikëqyrësit, programon kryerjen e punimeve, për çdo muaj, dhe korrigjon e përmirëson elemente të projektorganizimit për mosrealizimin e kushteve thelbësore të kontratës.

6. Sipërmarrësi përzgjedh drejtuesit dhe punonjësit e kantierit, me përvojë pune në objekte të ngjashme, aftësi të mjaftueshme teknike, organizative e profesionale, për realizimin e punimeve të kontraktuara, me njohuri të domosdoshme për legjislacionin e ndërtimit, administrimin, marrëdhëniet e ndërsjella të bashkëpunimit e komunikimit.

6.1 Sipërmarrësi është i detyruar të zëvendësojë, menjëherë, përfaqësuesit e vet dhe punonjësit e tjerë të kantierit, kur kjo kërkohet nga investitori ose mbikëqyrësi i punimeve.

6.2 Sipërmarrësi, prej fillimit deri në ditën e kolaudimit të punimeve, mbulon me shpenzimet e veta, korrigjon e zhdëmton çdo dëm që shkaktohet nga paaftësia, neglizhenca, të metat në zbatim, mungesa e masave mbrojtëse e sinjalizuese, e përfaqësuesve dhe punonjësve në:

a) pronën e të tretëve dhe në mjedisin në afërsi;

b) rrjetin e infrastrukturës së zonës, në kantier e në afërsi;

c) punimet e ndërtimit, administrimin dhe përdorimin e makinerive, të pajisjeve, materialeve dhe produkteve në kantier.

7. Sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë me nismën e vet, të subjektit projektues a mbikëqyrës, projektin dhe përshkrimet teknike të tij.

7.1 Sipërmarrësi është i detyruar të zbatojë çdo ndryshim të urdhëruar me shkrim nga investitori ose persona të autorizuar prej tij, që nuk ndryshon, në thelb, kushtet kryesore të projektit, të kontratës dhe nuk rrit vleftën e saj.

7.2 Propozimet për rritjen e vleftës së kontratës dhe zgjatjen e afatit të punimeve i paraqiten investitorit, nëpërmjet mbikëqyrësit të punimeve, kur ato përmirësojnë treguesit e veprës, vijnë nga shkaqe pamundësisht të paparashikueshme, në kohën e duhur dhe nuk janë në kundërshtim me kushtet e kontratës.

7.3 Ndryshimet e miratuara nga investitori sipas pikave 7.1 e 7.2 të këtij kreu, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm teknik, ekonomik e administrativ, i dorëzohen zyrtarisht, sipërmarrësit.

8. Sipërmarrësi është përgjegjës për kontrollin dhe respektimin e kërkesave të kontratës për cilësinë e punimeve. Ai është i detyruar të kryejë të gjitha provat dhe inspektimet në punimet e ndryshme të ndërtimit, të detyrueshme nga kushtet teknike në fuqi.

8.1 Provat dhe inspektimet shtesë, që kërkohen nga mbikëqyrësi për të verifikuar konformitetin e punimeve me projektin e specifikimet teknike, kryhen nga sipërmarrësi, sipas kushteve të kontratës.

8.2 Me kërkesë të investitorit, përshkrimet teknike të projektit dhe specifikimet teknike mund t'u referohen standardeve, normave e rregullave teknike të vendeve të tjera, kur ato janë më të përparura se ato në fuqi, kur nuk sjellin rritjen e vleftës së investimit apo ndryshime të kushteve thelbësore të kontratës dhe i dorëzohen sipërmarrësit para fillimit të punimeve.

8.3 Dokumentacioni fotografik apo videoregjistruesi sigurohet nga sipërmarrësi për çastet më të rëndësishme të zbatimit të punimeve, veçanërisht për ato që bëhen të padukshme, që mund të jenë objekt diskutimi në të ardhmen dhe që pasqyrojnë masat mbrojtëse e të kontrollit të cilësisë së materialeve e të punimeve, etj. Kopje të mjaftueshme i dorëzohen mbikëqyrësit çdo javë.

9. Sipërmarrësi kryen punime të veçanta, të parashikuara në kontratë me nënsipërmarrje, vetëm me miratim paraprak të investitorit. Marrëdhëniet dhe kushtet e nënsipërmarrjes rregullohen me marrëveshje dypalëshe, e cila në asnjë rast nuk duhet të bjerë në kundërshtim me detyrimet kontraktore të sipërmarrësit. Sipërmarrësi i punimeve është, në çdo rast, përgjegjës ndaj investitorit për punimet e nënsipërmarrjes dhe dokumentacionin teknik, ekonomik e administrativ.

9.1 Nënsipërmarrësi i punimeve të veçanta të ndërtimit duhet të plotësojë kushtet e një subjekti të mirëfilltë për zbatim punimesh.

9.2 Kur investitori bindet që nënsipërmarrësi shkel kushtet e kontratës, lajmëron, me shkrim, sipërmarrësin për zgjidhjen e marrëveshjes dhe largimin nga kantieri të nënsipërmarrësit.

9.3 Sipërmarrësi i punimeve nuk mund të pretendojë për zhdëmtim a ndryshim të kushteve të kontratës në rastet e zgjidhjes së marrëveshjes së nënsipërmarrjes.

10. Materialet që dalin nga lirimi i sheshit të ndërtimit, i takojnë investitorit në kushtet, kufizimet a përjashtimet, që përcaktohen në kontratë.

10.1 Kur gjatë zbatimit të kontratës hasen, gjenden punime a materiale me vlerë për trashëgiminë kulturore, punimet ndërpriten menjëherë dhe njoftohet investitori.

11. Sipërmarrësi, jo më pak se 10 ditë përpara fillimit të punimeve, njofton me shkrim seksionin e urbanistikës, që ka lëshuar lejen, dhe degën rajonale të Policisë së Ndërtimit.

Në njoftim jepen të dhëna për objektin, investitorin/sipërmarrësin, subjektin projektues e mbikëqyrës, dokumentacionin administrativo-ligjor të miratuar dhe për personelin drejtues të kantierit të punimeve.

11.1 Seksioni i urbanistikës njoftohet, zyrtarisht, nga sipërmarrësi për kontrollin e punimeve menjëherë me piketimin e objektit, me përfundimin e punimeve në kuotën +/-0,00 dhe në përfundim të karabinasë.

Ndërmjet palëve, në çdo rast, mbahet procesverbal.

11.2 Në degën rajonale të Policisë së Ndërtimit, së bashku me njoftimin, dorëzohen në fotokopje të noterizuara:

a) vendimet dhe aktet përkatëse, miratuese, të sheshit, të destinacionit e kushteve urbane, lejes së ndërtimit dhe projektit. Për ndërtime në zona me vlera të veçanta (muzeale, turistike, mjedisore), lejet dhe aktet miratuese nga organet e autorizuar nga ligji;

b) dokumentacioni i pronësisë mbi truallin e ndërtimit;

c) studimet inxhinierike për ndërtimin e objektit;

ç) plani i vendosjes së objektit dhe i sistemimit të territorit;

d) lidhja e objektit me infrastrukturën e zonës;

dh) plani i ngritjes dhe i organizimit të kantierit.

11.3 Dega e Policisë së Ndërtimit krijon dosjen e dokumentacionit, për çdo sipërmarrës, ku arkivohet dokumentacioni sipas pikës 10.2 të këtij kreu, kontrollet e ushtruara dhe korrespondenca përkatëse.

11.4 Seksioni a zyra e urbanistikës dhe Policia e Ndërtimit dërgojnë të dhëna në ministrinë, që mbulon veprimtarinë e ndërtimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe propozojnë masa për shkeljet ligjore në zbatimin e punimeve nga ana e sipërmarrësit.

KREU II

ZBATIMI I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

Drejtori i punimeve, për fillimin e punimeve në kantier, merr në dorëzim:

a) Dokumentacionin identifikues ligjor, teknik e fiskal të sipërmarrësit (vendime, licenca, certifikata, autorizime);

b) Formularët e dhënies së lejes për shesh dhe të lejes së ndërtimit;

c) Projektin e zbatimit, të nënshkruar nga subjekti projektues, shoqëruar me përshkrimet teknike;

ç) Vëllimet e punimeve, në lloje dhe zëra;

d) Kontratën e sipërmarrjes dhe specifikimet teknike;

dh) Projektin e përditësuar të rrejtit nëntokësor të infrastrukturës, në territorin e kantierit;

e) Pikat e autorizuar të lidhjes provizore të kantierit me infrastrukturën e zonës;

ë) Planin e vendosjes së objektit dhe të sistemimit të territorit;

f) Studimet inxhinierike, që lidhen me zbatimin e punimeve;

g) Planorganizimin e punimeve;

gj) Akte, ligjore e nënligjore, për zbatimin e punimeve të ndërtimit (udhëzime-kushte teknike-standarde-rregullore) dhe aktet e sipërmarrësit për organizimin dhe funksionimin e kantierit të punimeve.

1.1 Përgjegjësi teknik i kantierit merr në dorëzim, me procesverbal të rregullt nga subjekti projektues, hartat/relievat topografike, pikat e referimit topogjeodezik (reperët), që sigurojnë lidhjen e objektit me terrenin. Ato ruhen deri në përfundim të kolaudimit të punimeve.

1.2 Rrethimi i kantierit bëhet në përputhje me kushtet urbane, të përcaktuara nga organi i autorizuar.

1.3 Në vende të dukshme në kantier vendoset tabela e identifikimit të punimeve me të dhënat për objektin, destinacionin, lejen e ndërtimit, investitorin, subjektin projektues e mbikëqyrës dhe afatet e ndërtimit.

2. Përgjegjësi teknik i kantierit verifikon saktësinë e lidhjes së objektit me terrenin dhe të piketimit të tij. Ai është përgjegjës për zbatimin e përpiktë të projektit, sipas vizatimeve,

përshkrimeve teknike e ndryshimeve të miratuara prej tyre, në përputhje me kërkesat e kushteve teknike të zbatimit, në fuqi, me specifikimet teknike të kontratës dhe sipas radhës teknologjike të punimeve.

2.1 Drejtori i punimeve njofton menjëherë mbikëqyrësin e punimeve për pasaktësitë, mospërputhjet, mungesat e të dhënave në vizatimet, përshkrimet e specifikimet teknike, paraqet propozimet e veta dhe pret udhëzimet e tij.

Mungesat, pasaktësitë a mospërputhjet nuk përbëjnë shkak për zgjidhje arbitrare apo justifikim të difekteve në punime.

3. Materialet dhe produktet e ndërtimit me standarde të detyrueshme vendosen në vepër kur janë shoqëruar me certifikatë cilësie, me rezultatet e provave dhe të analizave, që vërtetojnë ose vlerësojnë përputhshmërinë e tyre me standardet, që referohen në përshkrimet dhe specifikimet teknike.

3.1 Materialet dhe produktet e ndërtimit, që përdoren në punimet e ndërtimit, duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe pa difekte nga veprimet ose mosveprimet e sipërmarrësit.

3.2 Përgjegjësi teknik i kantierit, për materialet me standarde të detyrueshme, merr kampione dhe njihet me rezultatet e testimit të tyre. Kur rezultatet janë më të ulëta se kërkesat e projektit dhe se standardet, projektuesi dhe investitori njofton menjëherë për vlerësimin e pasojave dhe korrigjimin e difekteve.

3.3 Kur kantieri prodhon vetë materiale e produkte ndërtimi, me standarde të detyrueshme, duhet të jetë i pajisur me leje nga organi i autorizuar. Edhe për këto materiale veprohet njëllor sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.2 të këtij kreu.

3.4 Materialet dhe produktet e ndërtimit, që nuk pranohen nga mbikëqyrësi i punimeve, sepse nuk plotësojnë kërkesat e projektit dhe të kontratës, nuk vendosen në objekt.

4. Punimet e ndërtimit, që kanë të bëjnë me sigurinë e jetës e të shëndetit të njerëzve dhe mbrojtjen e mjedisit, merren në dorëzim me kontroll të dokumentuar në faza të ndërmjetme, sipas rregullave që përcaktohen në kushtet teknike të zbatimit.

Në planin e veprimit përcaktohen punimet, kontrolli i të cilave bëhet në prani të përfaqësuesve të investitorit dhe të subjektit projektues.

4.1 Mbikëqyrësi i punimeve njofton sipërmarrësin për difektet e vëna re dhe kohën e korrigjimit të tyre. Punimet me difekte nuk pranohen dhe nuk financohen deri në korrigjimin e tyre.

4.2 Punimet me difekte të pakorrigjuara, që nuk cenojnë sigurinë e veprës dhe pranohen nga investitori, financohen me çmime të reduktuara. Masa e reduktimit parashikohet në kontratë.

5. Sistemet e infrastrukturës (elektrike, ujë-gaz-ajërsjellës, kanalizim, sinjalizim, ngrohje-ventilim etj), të izolimit (nga uji-nxehtësia-zëri), të transportit (ashensorë, transportatorë etj.), të mbrojtjes nga zjarri a çdo sistem tjetër i lidhur në mënyrë të qëndrueshme me punimet e ndërtimit, merren në dorëzim pasi provohen pangarkesë, në përputhje me kushtet teknike në fuqi.

5.1 Provat pa ngarkesë kryhen nga sipërmarrësi në prani të përfaqësuesve të investitorit dhe të subjektit projektues. Ato dokumentohen në procesverbal, ku evidentohen metoda dhe ecuria e provës, të metat e vëna re e korrigjimet e tyre, si dhe parametrat e arritura.

6. Sipërmarrësi dhe drejtuesit e kantierit janë përgjegjës, sipas përkatësisë, për tërësinë e masave organizative, teknike e teknologjike, ekonomike e financiare, higjienike e mjedisore për zbatimin e legjislacionit të punës e atë teknik, që garantojnë kryerjen e punimeve të ndërtimit në objekt dhe atyre ndihmëse në kantier, në kushte të sigurta për jetën e shëndetin e njerëzve dhe mbrojtjen e mjedisit.

6.1 Sipërmarrësi detyrohet të sigurojë në kantier:

a) punëmarrës të aftë, të kontrolluar për shëndetin, me leje për ushtrim profesionale të veçanta (dëshmi, leje, autorizime), nga organet e autorizuar me ligj;

b) materiale, pajisje, mjete mbrojtëse, kolektive e individuale, dhe tabela paralajmëruese;

c) mbrojtjen e detyrueshme të skelave, të daljeve të jashtme të objektit, si dhe mbrojtjen e mekanizmave e të pajisjeve nga goditjet e rrymave elektrike;

ç) mirëmbajtjen dhe kontrollin periodik të makinerive e të mekanizmave të instaluar në objekt, për punë pa rrezik;

d) punonjës të kualifikuar dhe të autorizuar prej tij për instruktimin teknik dhe mbrojtjen në punë;

dh) rregullore, urdhra e udhëzime në fuqi, për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë;

e) librin e instruktimit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë të punëmarrësve.

6.2 Përgjegjësi teknik i kantierit ka këto të drejta dhe detyra:

a) Të instruktojë dhe riinstruktojë të gjithë punonjësit, çdo fillim muaji, në përputhje me programin mujor të punës;

b) Të instruktojë, veçanërisht, punonjësit e rinj, që fillojnë punë për herë të parë, skuadrat e individëve, që vijnë rishtaz në kantier, që fillojnë një proces të ri pune apo që vendosen në punime të veçanta me shkallë vështirësie;

c) Të largojë menjëherë nga puna çdo punëmarrës, që nuk zbaton masat e sigurimit teknik e të mbrojtjes në punë, si dhe të pezullojë punën kur nuk garantohen masat mbrojtëse;

ç) Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe të mekanizmave nga manovratorë të paafte;

d) Të hartojë aktin e marrjes në dorëzim të skelave të jashtme.

7. Drejtori i punimeve, sa herë që kërkohet, vë në dispozicion të mbikëqyrësit librin e kantierit, dokumentacionin e kontabilitetit teknik e të furnizimit të objektit me materiale e produkte ndërtimi, bën njoftime brenda kohës së duhur për inspektimin e punimeve të maskuara, për marrjen e kampioneve, kryerjen e provave, të analizave që parashikohen në rregullat teknike ose kërkohen shtesë nga mbikëqyrësi, paraqet fotografitë, kasetat filmike dhe çdo dokument tjetër, që provon saktësinë dhe cilësinë e produkteve e të punimeve.

7.1 Drejtori i punimeve, me urdhër të mbikëqyrësit, prish dhe ribën me shpenzimet e sipërmarrësit, brenda periudhës së korrigjimit të difekteve, punimet që rezultojnë me shkelje të kushteve teknike të zbatimit, standardeve e specifikimeve teknike, përshpejton kryerjen e punimeve tej grafikut dhe kohës normale të punës, pa asnjë kompensim, në raste të veçanta.

7.2 Mbikëqyrësi njofton vazhdimisht sipërmarrësin për porositë, urdhrat dhe udhëzimet e dhëna në ditarin e objektit, në zbatim të kontratës së punimeve dhe gjatë kolaudimit.

7.3 Sipërmarrësi siguron mjediset e përshtatshme dhe pajisjet e nevojshme për mbikëqyrësin, bashkëpunon për çmimet e reja të punimeve, që nuk përfshihen në kontratë e kërkesë-propozimet për ndryshimet e saj, si dhe merr prej tij aktin e përfundimit të punimeve e rezervat që do të parashtrihen për punimet gjatë kolaudimit.

8. Punimet e përfunduara dhe të marra në dorëzim në kantier paraqiten nga sipërmarrësi në situacione pjesore, sipas periudhave progresive të zhvillimit të punimeve, dhe në atë përfundimtar.

8.1 Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës.

8.2 Situacionet financohen nga investitori sipas kushteve që parashikohen në kontratë (sigurimi i kantierit, garancia e kontratës dhe e punimeve, paradhënia, periodiciteti, afatet e pagesës, ndalesat për vonesat, difektet e pakorrigjuara, gjobat), pasi kontrollohen e pranohen paraprakisht nga mbikëqyrësi i punimeve.

8.3 Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë.

8.4 Një pjesë e vlerës së përgjithshme të situacionit përfundimtar financohet, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, pas periudhës së garancisë së punimeve.

9. Në rastet kur sipërmarrësi nuk është në gjendje të respektojë afatin e kryerjes së punimeve për shkaqe që nuk varen prej tij, ai i paraqet mbikëqyrësit, të paktën dy muaj para përfundimit të afatit, një kërkesë-propozim për shtyrje afati dhe seksionit përkatës të urbanistikës një kërkesë për zgjatjen e afatit të lejës së ndërtimit.

9.1 Kushtet dhe detyrimet e palëve për ndërprerjen e punimeve përcaktohen në kontratë.

Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të ndërpresë punimet për arsye të ndikimit të kushteve klimatike në to, kundrejt një zgjatjeje korresponduese të afatit.

Ndërprerja ose zgjatja e punimeve, si pasojë e rezultatit të provave, nuk përbën shkak për zgjatjen e afatit të ndërtimit.

10. Mbikëqyrësi, me kërkesë të sipërmarrësit, vërteton në procesverbal datën e përfundimit të punimeve, sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara e kushteve të kontratës.

10.1 Investitori ka të drejtë të organizojë kolaudimin paraprak të punimeve me ekspertë, përfitues e persona të tjerë të interesuar, që, së bashku me kolaudatorin, përcaktojnë detyra për riparimin e të metave dhe mënjanimin e mangësive në zbatim, si dhe propozojnë periudhat e garancisë së punimeve e të kolaudimit të riparimeve, financimin përfundimtar e garancinë për punimet.

Kolaudimi i objektit fillon jo më vonë se një muaj nga data e përfundimit të punimeve.

10.2 Sipërmarrësi është përgjegjës për drejtimin, mbajtjen në gatishmëri, riparimin, mirëmbajtjen, ruajtjen e punimeve të ndërtim-montimit të objektit e të kantierit, deri në nënshkrimin e procesverbalit të kolaudimit. Objekti merret në dorëzim në datën e nënshkrimit të procesverbalit të kolaudimit.

10.3 Sipërmarrësi, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të procesverbalit të kolaudimit, heq ndërtimet e përkohshme dhe realizon punimet përfundimtare të sistemimit.

KREU III DOKUMENTACIONI TEKNIK I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

1. Gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, i cili përmban:

a) Dokumentacionin topografik të faktit për vendosjen e objektit e të rrjeteve të infrastrukturës, për lidhjen e themeleve e të bazamenteve me tabanin, për kontrollin në plan e lartësi të objektit, të strukturave mbajtëse etj.

b) Dokumentacionin teknik për kontrollin dhe marrjen në dorëzim të strukturave, proceseve të ndërmjetme e rrjeteve, përpara se ato të bëhen të fshehta, të punimeve të montimit të strukturave, makinerive e pajisjeve teknologjike, provave pa ngarkesë, rezultateve dhe ndreqjes së të metave.

c) Dokumentacionin e vlerësimit dhe të vërtetimit të konformitetit të materialeve dhe produkteve, që hyjnë në procesin e ndërtimit.

2. Puna e kryer dhe çastet më të rëndësishme gjatë ndërtimit të objektit pasqyrohen në librin e kantierit, që mbahet në formën e ditarit të objektit e të raportit të punimeve.

2.1 Ditari i objektit pasqyron ngjarjet më të rëndësishme gjatë ecurisë së punimeve, deri në fund të periudhës së garancisë së tyre. Në të pasqyrohen ndryshimet e urdhëruara të projektit, testimet dhe rezultatet, masat suplementare për ndreqjen e difekteve dhe rastet kur punimet kryhen në kushte të veçanta.

2.2 Raporti ditor i punimeve jep të dhëna për motin, temperaturat, punimet e kryera, burimet njerëzore e teknike të përdorura, kontrollet për sasinë dhe cilësinë e punës së kryer, difektet e korrigjimet e tyre, punimet dhe proceset e ndërmjetme, marrë në dorëzim nga zbatuesi.

2.3 Ditari mbahet një i vetëm për objektin, ndërsa raporti ditor mbahet i veçantë për çdo nënobjekt, nënsipërmarrës e zbatues.

3. Libri i instruktimit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë hapet menjëherë me fillimin e punimeve dhe mbahet në çdo kantier ose objekt, sipas përcaktimit që bën sipërmarrësi. Në libër pasqyrohen procesverbalet e instruktimit, emrat e punonjësve të instruktuar, atyre të aksidentuar, mbledhjet për sigurimin dhe mbrojtjen në punë, kontrollet, detyrat dhe masat e marra për zbatimin e tyre.

Udhëzimet për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë mbështeten në legjislacionin e punës dhe rregullat në fuqi.

4. Libri i masave mbahet për çdo objekt e nënobjekt, që ka preventiv dhe është dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve, gradualisht me zhvillimin e tyre.

5. Në regjistrin e kontabilitetit teknik në kantier pasqyrohen puna dhe materialet e përdorura në vepër, në përputhje me kërkesat e akteve, ligjore e nënligjore në fuqi.

6. Dokumentacioni teknik i kantierit vihet në dispozicion të personave që janë të autorizuar të kontrollojnë zbatimin e punimeve në objekt.

6.1 Libri i kantierit dhe i instruktimit për sigurimin teknik përbëhet nga fletë të numëruara e të vulosura nga sipërmarrësi.

6.2 Personat e autorizuar të investitorit, sipërmarrësit, administratës publike, që kane të drejtë kontrolli, shënojnë në librin e kantierit dhe në atë të instruktimit vërejtje për zbatimin e punimeve, akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe lënë detyra e kontrollojnë zbatimin e tyre.

Drejtnesit e kantierit marrin masa për ndreqjen e të metave dhe bëjnë shënimet përkatëse në libër.

7. Në rastet kur ndryshohet përgjegjësi teknik i punimeve në kantier, dokumentacioni teknik i hartuar dhe i grumbulluar si më lart i dorëzohet përgjegjësit pasardhës, në prani të sipërmarrësit dhe kjo pasqyrohet në ditarin e objektit.

8. Zbatuesi i punimeve, bazuar në dokumentacionin teknik të grumbulluar e përpunuar, në ndjekjen dhe kontrollin e punimeve harton deklaratën teknike për punimet e sipërmarrjes, e cila nënshkruhet nga drejtnesit teknikë e ligjorë të sipërmarrësit, përgjegjësi teknik i punimeve në kantier dhe i dorëzohet mbikëqyrësit, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i punimeve.

8.1 Në deklaratën teknike përcaktohet se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin e zbatimit, ndryshimet e miratuara dhe kushtet teknike të detyrueshme për zbatim, dhe se është ndërtuar tërësisht dhe nuk ka shmangie në drejtim të qëndrueshmërisë statike, funksionit e kushteve urbane, strukturat mbajtëse janë ndërtuar ose montuar me materiale e produkte ndërtimi të parashikuara në projekt, brenda standardeve e kushteve në fuqi, rrjeti i infrastrukturës, makineritë e pajisjet janë provuar dhe plotësojnë parametrat e parashikuara etj.

9. Në kantierin e punimeve krijohet e plotësohet gradualisht dosja teknike e objektit, ku sipas problematikës, mbahen:

a) Dokumentacioni administrativo-ligjor për sipërmarrësin, si person juridik, dhe sheshin e ndërtimit;

b) Projekti i zbatimit, përditësimet e ndryshimet, të miratuara gjatë zbatimit të punimeve, përshkrimet dhe specifikimet teknike;

c) Preventivi i punimeve, sipas llojeve e zërave në sasi të çmimet përkatëse dhe ndryshimet e tij;

ç) Studimet inxhinierike për ndërtimin e objektit dhe përditësimet gjatë zbatimit të punimeve;

d) Dokumentacioni teknik për punimet topografike, për punimet që bëhen të maskuara, për punimet e proceset e ndërmjetme, që merren në dorëzim, për provat pa ngarkesë të sistemeve, për ndreqjet e të metave gjatë periudhes së garancisë së punimeve;

dh) Certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre;

e) Projektorganizimi i punimeve;

ë) Kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontratës së sipërmarrjes;

f) Libri i kantierit, i sigurimit teknik e mbrojtjes në punë dhe libri i masave;

g) Regjistri i kontabilitetit;

gj) Deklarata teknike e punimeve.

9.1 Dosja teknike e objektit, pas kolaudimit të punimeve, i dorëzohet sipërmarrësit dhe ruhet në arkivin teknik të tij.

9.2 Investitori dhe mbikëqyrësi i punimeve krijojnë dosjen teknike të përbashkët, e cila arkivohet pranë investitorit.

9.3 Dosja teknike e objektit është dokument i rëndësisë së veçantë dhe ruhet sipas afateve të caktuara me ligj.

KREU IV TË TJERA

1. Ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, kur është e nevojshme, nxjerr norma e rregulla për mbajtjen e dokumentacionit teknik dhe organizimin e kantierit.

2. Ky udhëzim zbatohet edhe për punimet e ndërtimit me financime të huaja, për aq sa nuk bie në kundërshtim me kushtet e marrëveshjeve në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

UDHËZIM
Nr. 132, datë 18.5.2005

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR.4, DATË 11.6.2003 “PËR
DHËNIEN ME QIRA TË PASURIVE TË NDËRMARRJEVE, SHOQËRIVE DHE
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 2 e Kushtetutës, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.315, datë 24.4.2003 “Për dhënie me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.323, datë 21.5.2004 “Për disa shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.315, datë 24.4.2003” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.629, datë 27.8.2004 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.315, datë 24.4.2003”, Ministri i Ekonomisë nxjerr këtë

UDHËZIM:

Në udhëzimin nr.4, datë 11.6.2003 të Ministrit të Ekonomisë, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Paragrafi i parë i shkronjës “a” të pikës 3 ndryshohet si më poshtë:
 - a) “Për sipërfaqe deri në 200 m², lidhja e kontratës bëhet nga organi drejtues i ndërmarrjes, shoqërisë e institucionit për një afat deri në 1 vit. Për dhënie me qira mbi këtë afat merret miratimi i organit të varësisë administrative”.
2. Pas shkronjës “c” të pikës 3 shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:
 - d. “Rinovimi i kontratës së qirasë bëhet:
 - kur subjekti ka realizuar kushtet e kontratës së parë në drejtim të investimit, punësimit dhe shlyerjes së plotë të detyrimit të qirasë;
 - merr përsipër rritjen e investimit dhe punësimit.”
3. Në fund të pikës 4 shtohet ky paragraf me këtë përmbajtje:

“Institucionet qendrore dhe vendore vendosin kritere shtesë për objektet që jepen me qira për qëllime kulturore, sportive dhe arsimore.”.
4. Paragrafi i parë i pikës 5 ndryshohet si më poshtë:

“Ndërmarrja, shoqëria ose institucioni shtetëror përgatit dokumentacionin për objektet, pasuritë e saj, që do të jepen me qira:

 - genplanin e sipërfaqes gjithsej të vulosur nga zyra e urbanistikës dhe drejtuesi i ndërmarrjes;
 - vlerësimin për makineritë që jepen me qira;
 - certifikatën apo vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme që objekti është në pronësi shtetërore, apo nuk është regjistruar në pronësi private;
 - miratimin e ndërmarrjes për qiradhënie e objektit.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Anastas Angjeli

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 26.5.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë